



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

04NR. 630 - /2022

Klinë, 29.04.2022

KONTRATA NR. 2 /2022-DKA

KOMUNA KLINË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, nenit 19, Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar, pika 4, kontrata me vlerë minimale, që përfaqësohet nga drejtori i institucionit arsimor, Dr.sc.Qemajl Sejdiq, në njërën anë;

Dhe

GIKA SH.P.K. (në vazhdim "Furnizuesi"), me adresë - KLINË NR. UNIFIKUES 811449512 të cilën e përfaqëson Granit Kalludra, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

"FURNIZIM, MONTIM I TABELËS EMËRTUESE NË FSHATIN PËRÇEVË" me numër identifikues:634-22-22-147

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë FURNIZIM – **"FURNIZIM, MONTIM I TABELËS EMËRTUESE NË FSHATIN PËRÇEVË"** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

III.1) PËRSHKRIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS:

Artikull	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi- (duke përfshirë gjitha taksat etj)	Cmimi Total -
1	Sipas specifikacionit të bashkëngjitur pozicioni 1.	cope	1	280	280.00
2	Sipas specifikacionit të bashkëngjitur pozicioni 2.	cope	1	33.00	33.00
				Totali i	313.00

1.2. Sipas karakteristikave të dhëna në ofertën financiare të bashkëngjitur në këtë kontratë

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë– 2 DY DITË nga koha e nënshkrimit të kontratës .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë NE VENDET E CAKTUARA NGA ORGANIZATORI – Klinë

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetët DDP –KLINE.

Neni 3

Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4

Çmimi

4.1 Çmimi total I furnizimeve duhet të jetë: **313.00 €.**

DDP (të gjitha të përfshira në çmim (dogana, taksa lineare dhe TVSH)

(TREQIND E TREMBËDHJETË E TRE EURO).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 .Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Pagesa do të bëhet siq vijon: **Me të pranuar të mallit me faturë dhe Fletëdorëzim-fletëpranim .**

Neni 5

Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paçartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6

Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin

e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Menagjimin e kontratës në bazë të Nenit 81 të LPP 05/L-068 do ta bëjë

DREJTORI I DKA-së, KLINË - Dr.sc.Qemajl Sejdijs

Për Furnizuesin GIKA SH.P.K.		Për Autoritetin Kontraktues DREJTORI I DKA-së	
Emri:	GRANIT KALLUDRA	Emri:	QEMAJL SEJDIJA
Pozita:	PRONAR	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.04.2022	Data:	29.04.2022
Vula:		Vula:	

PARAMASA: Furnizim, montim i tabelës emërtuese të shkollës dhe furnizim me mirënjohje

NR.	Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizim, montim i tabelës emërtuese të shkollës. Specifikacioni: Tabela të ketë cilësi të mirë me ndriçim led, rezistente ndaj ujit dhe diellit. Dimenzionet 2m x 0.50m. Emri i shkollës sipas vendimit të MASHT-it, sipas modelit të shënuar më poshtë pa ndryshime gjuhësore dhe teknike. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "XHAFER GASHI" Përçevë - Klinë	Copë	1	280	280,00
2	Furnizim me Mirënjohje A4 (letra të jetë cilësi e mirë), imazhin dhe tekstin e mirënjohjes e zgjedh DKA	Copë	30	1,10	33,00
GJITHSEJ					313,00

